KËSHILLI I NDERIT pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, SHGM, duke vepruar në bazë të parashtresës së Klinikës së Gastroenterohepatologjisë kundër gazetarit Furkan Saliu nga Tv Klan, për kronikë të transmetuar më datë 25.07.2023, në seancën e Këshillit solli këtë

V E N D I M

PRANOHET PARASHTRESA NGA KLINIKA E GASTROENTEROHEPATOLOGJISE KUNDËR GAZETARIT FURKAN SALIU DHE KONSTATOHET SHKELJE E KODIT TË GAZETARËVE NË PJESËN „MUNGESA E PALËS SË DYTË“

A r s y e t i m

Klinika e GASTROENTEROHEPATOLOGJISË, në kuadër të Qendrës Klinike “Nënë Tereza” – Shkup, ka dorëzuar një reagim deri te Këshilli i Nderit, për një kronikë të gazetarit Furkan Saliu, të transmetuar në Tv Klan, më datë 25.07.2023, storje për një paciente për të cilën nuk ishin kujdesur në disa klinika.

Klinika thekson se nuk është kontaktuar fare dhe nuk është kërkuar asnjë qëndrim zyrtar për rastin në fjalë, ndonëse gazetari Furkan Saliu ka hyrë dy herë në klinikë, një herë me familjen e pacientes dhe herën e dytë vetëm, për ta vizituar atë, megjithëse vizitat lejoheshin vetëm për familjen dhe në të njëjtën kohë nuk ka kërkuar mendim për rastin nga Klinika.

Reagimi i klinikës vë në dukje shkeljen e Kodit të Gazetarëve, por edhe motivet e gazetarit për realizimin e storjes, i cili shkon përtej normave profesionale dhe përfshin motive personale dhe private.

Këshilli i Nderit, me rastin e reagimit të Klinikës në këtë pjesë, i bën me dije gazetarëve se duhet të mbajnë distancë profesionale në rastet ku punojnë dhe çdo përfshirje shtesë për motive personale apo të tjera mund të cenojë objektivitetin e tyre dhe të kalojë kufirin, deri ku janë ata gazetarë, dhe prej ku tanimë përfshihen në rastin konkret.

Pas marrjes së përkthimit të kronikës në gjuhën maqedonase, Këshilli i Nderit konstaton se reagimi i Klinikës për mungesë përfaqësimi të palës tjetër është i arsyeshëm, kronika është konfuze dhe e paqartë dhe në fund, pas shtrimit në spital të pacientes e cila ishte e drejtuar në disa klinika, përfundon sërish me një koment të familjes, në bazë të të cilit bazohet e gjithë storja dhe nuk ka asnjë burim të vetëm zyrtar nga klinikat ku pacientja është ekzaminuar para se të mbahet në përkujdesje.

Krahas kësaj, në kronikë gazetari Furkan Saliu përdor të dhëna për gjendjen shëndetësore të pacientes nga Klinika për Sëmundje Infektive, të cilat, siç thekson ai, “janë siguruar nga TV Klan”.

Ligji për Mbrojtjen e Pacientëve garanton konfidencialitetin e të dhënave të pacientit, ndaj gazetari apo media nuk mund të mbledhin vetë të dhëna, t'i përpunojnë dhe t'i nxjerrin në publik, sepse në këtë mënyrë cenohen të drejtat e pacientëve. Gjendja shëndetësore e pacientëve janë të dhëna personale, të cilat mediat duhet t'i trajtojnë me shumë kujdes edhe në rastet kur e marrin vesh nga vetë pacienti apo familjarët, por nuk guxojnë asesi të mbledhin dhe publikojnë të dhëna të tilla.

Këshilli i Nderit mbështet gazetarinë investigative, gazetarinë guerile, inkurajon gazetarët të shkruajnë për tema me interes publik, siç janë problemet në shëndetësi, por në të njëjtën kohë tregon një qasje serioze, respektim të vazhdueshëm të normave ligjore dhe ndjeshmërinë e temave si dhe respektimin e Kodit të Gazetarëve, kur bëhet fjalë për raportimin e palës së dytë dhe të balancuar, me ndarje të kujdesshme të fakteve nga komentet dhe futjen e interesave personale gjatë përpunimit të lajmeve.

Për këto arsye, Këshilli konkludoi se në këtë rast ishte shkelur Kodi i Gazetarëve.

-Të dorëzohet deri te:

- Klinika e Gastroenterohepatologjisë,

- Të publikohet në faqen e SHGM-së

Këshilli i Nderit pranë SHGM-së

Kryetar

Sashe Dimovski